

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E RAHOVECIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i prokurimit	623-26-2019-1-2-1
Nr i brendshëm	623-26-005-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AGIMI-DE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sheshi Mentor Tolaj

(Adresa)

Decan

(Vendi)

044/635-635

(Numri Telefonit)

51.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Hajrije Selmanaj- Drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë)

info@agimi-de.com

(Adresa elektronike)

10.06.2026.

(Data e parashtrimt të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/ _____
(Emri i avokatit)

/ _____
(Adresa e plotë)

/ _____
(Numri i Telefonit)

/ _____
(Numri i faks-it)

/ _____
(Adresa elektronike)

/ _____
(Data e parashtrimit të ankesës)

/ _____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 09.04.2026.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 28.04.2026.

Data dhe ora e hapjes së ofertave: 28.04.2026. ora 14:30

Njoftimi mbi vendimin e AK: 22.05.2026.

Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me cmimin me të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesverbalin e hapjes së ofertave e kemi pranuar në e-prokurim.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 22.05.2026.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 28.05.2026.

Njoftimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 29.05.2025.

Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 01.06.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52.3- Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës

Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie të Kontratave

Neni 59.4- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60- Kriteret për dhenie të kontrates

Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 32.5 I Rregullore për prokurim publik- Dorëzimi i tenderit në formë elektronike

Neni 37.4 I Rregullor për prokurim publik- Mostrat e Tenderëve

Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 22.05. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE i renditur i dyti Mebli Dizajn shpk Kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin, citoj:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si Operator Ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Mungesa e identifikimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik. Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit ku kërkohet që Operatori Ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar, duke lënë atë të paplotësuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Neni 32, pika 32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike;

Juve si Operator Ekonomik nuk e keni identifikuar kodin e mostrave në formularin e tenderit elektronik. Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit ku kërkohet që operatori ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

Ky konstatim i AK komisionit vlersues nuk qendron, ne formularin e tenderit tek pjeset e tenderit qe dorezohen ndaras ne kemi cekur Mostrat.

AK ne leter standarde per eliminim ka cekur nenin 32.5 te rregullores per prokurim publik, ne kemi dorezuar oferten dhe mostrat ne perputhje me kete dispozite ligjore, citoj:

*32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogjet dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, **mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike.***

Ne nenin 32.5 te Rrpp nuk specifikohet se duhet te pershkruhet kodi i mostrav ne formularin e tenderit, AK/Zyra e prokurimit tenton te interpretoje ne nje forme tjetere kete dispozite ligjore me qellim te eliminimit te ofertes sone.

Ne ne formularin e tenderit kemi specifikuar pjeset e tenderit qe dorezohen ndaras-Mostrat.

Ne baze te nenit 37.4 te Rregullores per prokurim publik në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes mostrave të dorëzuara duhet ti eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE.

Edhe AK/Zyra e prokurimit ne hartimin e kriterit nr 3 ne FDT lidhur me mostrat ka cekur se mostrat duhet te dorezohen konform nenit 37 te Rregullores per prokurim publik, citoj:

RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK, Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i

- a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe
- b. shënohen nga një kod

Ne procesverbalin per dorezimin e mostrave jemi identifikuar me kodin 2804 nga zyrtari i prokurimit i cili ka pranuar mostrat dhe nuk ka ndonje parregullesi ne dorezimin e mostrav prandaj arsyeja per eleminim nuk qendron.

Autoriteteve kontraktuese ne baze te nenit 52.3, 56.3 dhe 59.4 te LPP-se nuk i lejohet te eliminoje operatorin ekonomik ne baze te nje kerkese e cila me pare nuk eshte parashtruar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit.

AK perveq qe ka elemnuar kompanine tone pa te drejte, ne anen tjeter ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili nuk ka plotesuar kriterin nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional pasi qe nuk ka dorezuar katalogun e te gjitha produkteve.

Kriteri nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional ne FDT eshte parashtruar te dorezohet:

Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve te ofruara me katalogë/broshura;

Dëshmia 2: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë broshura për produkte të ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike;

OE ka dorezuar katalog vetem per pozicionet nr. 14, 16, 18, 20, 22, 26, 34, 35, 36, 40, 49, 50, 51, 53, 62, 65, 68, 70, 71 dhe 73 ndersa per produktet me nr rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 63, 64, 66, 67, 69, 72 fare nuk ka dorezuar katalogun dhe specifikimet teknike.

Ne baze te rregullores dhe udhezimit per prokurim publik ne rast kur mungon specifikimi teknik dhe katalogu per produktet e ofertuara, kusht administrativ eshte te refuzohet tenderi pa kerkuar informacion te metutjeshem.

AK/ Zyra e prokurimit ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim fare nuk ka shqyrtuar kete pretendim ankimor.

Prandaj konstatojme se OE Mebli Dizajn shpk eshte i papergjegjshem.

Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues jashteligjshem ka vendosur per eleminimin e ofertes sone dhe shperblimin me kontrate per OE te papergjegjshem dhe i cili ka dorezuar oferten me cmim me te larte.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek eleminimi i ofertes sone pa te drejte, ne kete menyre na eshte mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontrate dhe nuk eshte respektuar neni 60 i LPP-se qe kontrata ti ipet kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*